



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

Në bazë të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ të MASHT nr. 4/2010 të dt. 27.4.2010, përkitazi me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ të MASHT nr. 01/2009 të dt. 6.1.2009, Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve shpall

FTESË PËR PARAQITJEN E APLIKIMEVE

për

- A) Akreditimin e ofertuesve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve
- B) Akreditimin e programeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve

Kushtet e përgjithshme

- A) Kushtet e përgjithshme për akreditimin e ofertuesve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë përcaktuar me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 4/2010:
 - 1. Të drejtë aplikimi për akreditim institucional kanë të gjithë personat juridik të regjistruar në Kosovë dhe në vendet tjera që kanë programe zhvillimi profesional për punëtorë arsimit.
 - 2. Organizatat që aplikojnë për akreditim institucional me qëllim të ofrimit të programeve të zhvillimit profesional duhet të dorëzojnë:
 - 2.1. Të dhënat themelore duke dëshmuar emrin, statusin, fushëveprimtarinë e organizatës;
 - 2.2. Referencat për aktivitetet e mëhershme;
 - 2.3. Të dhënat për personelin udhëheqës dhe personelin përgjegjës për aktivitetet trajnuese të organizatës.
 - 3. Institucionet publike, qeveritare, ndërqeveritare dhe organizatat me status të njohur ndërkombëtar që kanë marrëveshje me MASHT për zhvillimin e aktiviteteve të zhvillimit

profesional të punëtorëve të arsimit konsiderohen të akredituara për periudhën e kohëzgjatjes së marrëveshjes.

B) Kushtet e përgjithshme për aplikimin e programeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë përcaktuar me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 4/2010:

Organizatat që aplikojnë për akreditim të programeve të tyre duhet të dorëzojnë aplikacionin për akreditim duke përfshirë të dhënat në vijim:

- 1.1. Historikun e zhvillimit/realizimit të programit të propozuar, nëse është e zbatueshme;
- 1.2. Emërtimi i programit;
- 1.3. Tipi i programit: themelor ose plotësues;
- 1.4. Rezultatet e pritura ose objektivat e programit;
- 1.5. Përmbajtja e programit;
- 1.6. Metoda e punës për realizimin e programit;
- 1.7. Grupi i synuar i mësimdhënësve;
- 1.8. Numri i parashikuar i pjesëmarrësve në sesionet e trajnimit;
- 1.9. Metodat e vlerësimit të arritjes së rezultateve të pritura nga programi;
- 1.10. Materialet që do të përdoren në zbatimin e programit;
- 1.11. Biografia dhe përvoja e ligjëruesve të programit;
- 1.12. Forma e certifikatës që dëshmon pjesëmarrjen në program

Në përputhje me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 4/2010 mund të akreditohen edhe programe që janë realizuar në të kaluarën pa pasur nevojë për akreditim institucional.

Dokumenti i plotë i Udhëzimit Administrativ mund të merret nga web adresa <http://www.masht.gov.net/advCms/#id=1338>.

Mënyra e aplikimit dhe afati

A) Organizatat e interesuara për akreditim institucional, krahas dokumentacionit të përshkruar në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 4/2010, paraqesin edhe:

- Formularin për aplikim (kërkohet përmes e-mailit të dhënë më poshtë)
- Dëshminë për regjistrimin e biznesit ose certifikatën e regjistrimit në regjistrin e OJQ-ve;
- Organizatat e regjistruara në Kosovë paraqesin edhe certifikatën e numrit fiskal.

B) Organizatat e interesuara për akreditimin e programeve të zhvillimit profesional, krahas dokumentacionit të përshkruar në nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 4/2010, paraqesin edhe :

- Formularin për aplikim (kërkohet përmes e-mailit të dhënë më poshtë)

Informata shtesë për procedurat e aplikimit mund të merren në adresën vijuese:

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Sektori për trajnimin e mësimdhënësve

Në vëmendje të: Igballe Cakaj
rr. "Agim Ramadani", p.n.
Prishtinë
Tel. 038/200 21024
E-mail: Igballe.Cakaj@ks-gov.net

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në këtë adresë ose dërgohen me postë jo më vonë se më
20 korrik 2010 në orën 16.